



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT**

**RREGULLORE
MBI PERDORIMIN E SHERBIMIT TE
INTERNETIT NE ADMINISTRATEN PUBLIKE**

Versioni 1.0

**PUBLIKUAR PËR HERË TË PARË
VERSIONI AKTUAL**

**02/12/2008
02/12/2008**

FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT

Historiku i versionit dhe ndryshimeve të dokumentit

Data	Autori	Versioni	Shënime mbi rishikimet
02/12/2008	AKSHI	1.0	

Atributet e dokumentit

Emri i skedarit	Pronari i skedarit	Vendndodhja e skedarit

Kjo faqe është lënë qëllimisht bosh

PËRMBAJTJA

FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT	2
PËRMBAJTJA	4
1. Hyrje.....	5
2. Qëllimi.....	5
3. Përkufizime	5
4. Rregulla mbi përdorimin e shërbimit të internetit në administratën publike.....	6
4.1 Të përgjithshme.....	6
4.2 Të drejtat dhe detyrimet	7
4.3 Ruajtja e Privatësisë së punonjësve.....	9
5. Sanksionet	9
6. Hyrja në fuqi.....	9

1. HYRJE

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit bazuar në VKM Nr.248 dt 27.04.2007, në zbatim të pikës 3 gërma ç) që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK për administratën publike, ka hartuar këtë rregullore “Për përdorimin e shërbimit të internetit në administratën publike”.

2. QËLLIMI

Qëllimi i kësaj rregulloreje është që administrata publike të udhëhiqet në praktikën e saj të punës nga zbatimi i rregullave për përdorimin e internetit në administratën publike :

- a. duke marrë në konsideratë faktin që Qeveria e Republikës së Shqipërisë në programin e saj qeverisë mbështet përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe internetin;
- b. duke konsideruar se përdorimi i TIK bazuar në rregulla të qarta:
 - i. rrit efikasitetin në punën e administratës publike
 - ii. krijon lehtësime dhe shërbime komunikimi
- c. duke marrë parasysh rritjen e aksesit në internet nga punonjësit e administratës publike;
- d. duke konsideruar të rëndësishme etikën profesionale të administratës publike për të mundësuar sigurinë e konfidencialitetit, të dhënat personale, privatësinë, integritetin dhe publikimin e informacionit sipas legjislacionit në fuqi;
- e. për të shmangur anët negative të përdorimit të internetit duhet të:
 - i. evitohen problemet që mund të lindin si pasojë e përdorimit pa kriter të shërbimit të internetit që mundësohet nga Institucionet shtetërorë;
 - ii. evitohen dërgimet e dokumentave ose informacioneve, personave ose organizatave të paautorizuara;

3. PËRKUFIZIME

Në kuptim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet që vijojnë:

- *Firewall* – Pajisje apo një program kompjuterik që është i konfiguruar për të kontrolluar trafikun që kalon nëpër rrjet, duke e lejuar apo bllokuar atë në baze të një grupi rregullash.

- *IM Instant messaging, Chat* – Teknologji që japin mundësinë e komunikimit tekst në kohë reale midis dy apo më shumë bashkëbiseduesve në rrjet të mbyllur apo Internet.
- *UserID/Username* – Varg karakteresh që identifikon në mënyrë unike një përdorues në një sistem apo rrjet kompjuterik.
- *Password* – fjalëkalim, kod sekret i një përdoruesi që nuk duhet të njihet nga përdoruesit e tjerë, dhe që i përdorur bashkë me UserID, lejon aksesimin e një sistemi.
- *Logim* – procesi nëpërmjet të cilit një përdorues fiton akses në një sistem apo rrjet kompjuterik, i cili zakonisht nënkupton futjen e një UserID-je (username) dhe një fjalëkalimi (passwordi)

4. RREGULLA MBI PËRDORIMIN E SHËRBIMIT TË INTERNETIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

4.1 TË PËRGJITHSHME

Në këtë seksion do të përcaktohen disa rregulla të përgjithshme që duhet të jenë të qarta për çdo punonjës të administratës publike. Institucionet shtetërore janë përgjegjës për informacionin që ato trajtojnë. Për këtë arsye ata janë të detyruar të aplikojnë një sërë rregullash dhe procedurash për ruajtjen e integritetit dhe konfidencialitetit të informacionit.

a. Institucioni mund të autorizojë:

- Bllokimin e faqeve të caktuara të Internetit që gjykohen si të pavlefshme për punën (psh. me përmbajtje të paligjshme, diskriminuese, apo pornografike);
- Monitorimin e faqeve të Internetit dhe listës së tyre, të hapura në mënyrë kronologjike nga punonjësi;
- Shkarkimin e softeve nga Interneti;
- Përdorimin e faqeve me pagesë për informacion të vlefshëm për qëllime pune.

b. Punonjësit e administratës publike duhet të tregohen të kujdesshëm gjatë aksesimit të shërbimeve online me qëllim:

- Mirëpërdorimin e burimeve të Internetit
- Minimizimin e kërkimit të paautorizuar nga eprori i drejtpërdrejtë, në Internet;
- Ruajtjen e tërësisë së informacionit në Internet;
- Mos ç'aktivizimin e opsioneve të antivirusit për materialet që shkarkohen nga Interneti.

4.2 TË DREJTAT DHE DETYRIMET

Institucioni e trajton dhe vlerëson të gjithë informacionin elektronik si çështje të brendshme. Për këtë arsye, institucioni do të ndjekë të gjitha praktikrat dhe procedurat përkatëse për sigurimin, ruajtjen si dhe shkatërrimin e informacionit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

c. Të drejtat dhe detyrimet e njësisë së Teknologjisë së Informacionit (TI) në administratën publike:

Punonjësi i njësisë së Teknologjisë së Informacionit në ushtrimin e detyrës së tij/saj duhet të:

- i. Zbatojë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, konfidencialitetit të komunikimit, lirinë dhe të drejtat e njeriut.
- ii. Sigurojë që konfigurimi i të gjitha pajisjeve të sigurisë është një e dhënë konfidenciale vetëm për personelin teknik. I njëjti rregull vlen edhe kur stafi teknik është i jashtëm.
- iii. Sigurojë që për çdo kompjuter të lidhur në Internet aplikohet firewall dhe kontrollet e sigurisë së aksesit të konfigurohen në mënyre të tillë që asnjë aplikacion i brendshëm të mos hapë porta alternative komunikimi me Internetin
- iv. Sigurojë aksesin në Internet dhe pajisjen me fjalëkalime individuale të punonjësve;
- v. Ndërmarrë këshillime, që mund të përfshijnë trajnime intensive rreth rregullores dhe përdorimit të pajisjeve;
- vi. Vendosë opsionet e sistemit dhe kompjuterëve lokal në mënyre që përdoruesit mos të kenë të drejta të plota mbi softweret e sigurisë dhe antiviruset.
- vii. Bashkëpunojë me organet kompetente për sigurimin e informacionit të nevojshëm për çështje të sigurisë kombëtare dhe në rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- viii. Gjithashtu, me qëllim sigurimin e mbarëvajtjes së funksionimit të rrjetit të Internetit dhe rritjen e efikasitetit të tij, punonjësi i njësisë së teknologjisë së informacionit mund të monitorojë në përputhje me dispozitat ligjore:

- volumin e aktivitetit në Internet dhe kapacitetin e sistemit me qëllim sigurimin e funksionimit të tij në mënyrë efikente;
- faqet e aksesuara dhe kohën e shpenzuar për lundrimin e tyre;

d. Të drejtat dhe detyrimet e punonjësit të administratës publike:

Në kryerjen e detyrës së tyre punonjësit e administratës publike duhet të respektojnë parimet e përgjithshme të etikës të përcaktuara në ligjin nr 9131 dt.8.9.2003.

- i. Punonjësi ka të drejtë të përdorë shërbimin e Internetit për:
 - Komunikim dhe informim direkt në lidhje me problemet e Institucionit;
 - Komunikim dhe bashkëpunim për zhvillimin e tij profesional;
 - Kërkime, studime, standarde, këshillime, analiza dhe aktivitete profesionale dhe sociale të lidhura më punën dhe në përputhje me detyrat e punonjësve në administratën publike;
 - Çdo aktivitet zyrtar që nuk kërkon një nivel sigurie të lartë të rrjetit (psh aksesit në rrjetat e klasifikuara);
- ii. Punonjësit janë përgjegjës për ruajtjen e fshehtësisë së fjalëkalimeve personale (username/password) të tyre. Ata duhet të përdorin këto dhe vetëm këto fjalëkalime dhe nuk duhet ti shpërdorjnë ato. Në mënyrë të ngjashme, logimet e shumëfishta dhe të njëkohshme me të njëjtën UserID janë të ndaluara rreptësisht;
- iii. Punonjësit duhet të jenë të vëmendshëm që të mbyllin llogarinë e tyre personale në përfundim të punës;
- iv. Punonjësit janë përgjegjës për raportimin, nëse janë në dijeni, të shkeljeve dhe rreziqeve potenciale rreth sigurisë, si dhe të aktiviteteve joetike, që shkelin udhëzimet ose kodin e praktikës së institucionit
- v. Punonjësit janë gjithashtu përgjegjës për sigurimin e pajisjeve që ata përdorin nga keqpërdorimi, aksesit i paautorizuar ose dëmtimi i qëllimshëm gjatë punës.
- vi. Punonjësit i ndalohet përdorimi i shërbimit të Internetit për të:
 - Shkarkuar, përdorur dhe/ose shpërndarë:
 1. Materiale me përmbajtje diskriminuese (racial, kulturor, politik, gjinor apo fizik);
 2. Literaturë negative rreth drogave;
 3. Materiale pornografike;
 4. Materiale që përmbajnë shpifje;
 - Favorizuar biznesin privat – përfshirë këtu reklamat, lajmërimet, etj, – apo për qëllime politike.
 - Përdorur ose shpërndarë lojëra elektronike, përveç rasteve kur ato ndihmojnë në trajnimin ose ilustrimin e aktiviteteve profesionale;
 - Dërguar jashtë institucionit, shpërndarë, kopjuar ose modifikuar skedarët (file-s) dhe të dhëna të tjera që janë konfidenciale;
 - Shfrytëzuar identitetin e një personi tjetër, gjatë përdorimit të internetit;
 - Mbledhur fonde publike dhe/ose për aktivitete që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me publikun, jo specifikisht të lidhura me aktivitetin shtetëror të Institucionit;
 - Shkëmbyer mesazhe (Instant Messaging) ose bashkëbiseduar (si CHAT) për qëllime personale.
 - Transmetimi i dokumenteve ose mesazheve të klasifikuara nëpërmjet Internetit është i ndaluar, përveç rasteve kur specifikohet nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

4.3 RUAJTJA E PRIVATËSISË SË PUNONJËSVE

Për ruajtjen e privatësisë së të dhënave të punonjësve të administratës publike do të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr. 9887, datë 10. 03. 2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”.

5. SANKSIONET

Çdo veprim ose mosveprim në kundërshtim me këtë rregullore në rast se nuk përbën vepër penale, ndëshkohet me masa disiplinore sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

6. HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi pas publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike.